

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 3/2023**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR 2023 PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT  
TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2022-2026**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

- I. Miratohet plani vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026.
- II. Plani vjetor 2023 botohet në Fletoren Zyrtare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R E**

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën 26.1.2023